



VENDIM

Nr. 137, Datë 26.11.2015

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PER LICENCIMIN E SHOQËRISË
“PHOENIX PETROLEUM” SH.A.,NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT
TË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 22, pika 2, gërma “c” të Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror ” si dhe neneve 4, pika 1, gërma “c”; 8; 9 pika 1 dhe pika 2, gërma “f” dhe nenin 10, pika 1 të “Rregullave dhe Procedurave për Liçensimin, Ndryshimin, Transferimin e Pjesshëm ose të Plotë, Heqjen dhe Rinovimin e Liçensave në sektorin e Gazit Natyror”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria PHOENIX PETROLEUM sh.a si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të shoqërisë PHOENIX PETROLEUM sh.a.

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë PHOENIX PETROLEUM sh.a., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në *Rregullat dhe Procedurat për Liçensimin, Ndryshimin, Transferimin e Pjesshëm ose të Plotë, Heqjen dhe Rinovimin e Liçensave në sektorin e Gazit Natyror*”si më poshtë:

- Formati dhe Dokumentacioni për Aplikim, (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni Ligjor, Administrativ dhe Pronësor, (neni 9, pika 1, gërma d/i; d/ii ; d/v;d/vi) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni dhe Garancitë Financiare dhe Fiskale, (neni 9, pika 1, gërma e/i; e/ii; e/iii; e/v; e/vi) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumente specifike për llojin e licensës, (neni 9, pika 2, germa f/i;) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- nenin 9, pika 2, germa f/ii (mbi garancinë që cilësia e furnizimit të gaz përmbushë kriteret minimale të operatorit të sistemit);
- nenin 9, pika 1, germa d/V, (dokumentacioni që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka),
- nenin 9, pika 2, germa f/iii (kapitalin financiar dhe mbështetja financiare e nevojshme për kryerjen e aktivitetit),

do të njoftohet subjekti që në bazë të Rregullave dhe Procedurave për Liçensimin, Ndryshimin, Transferimin e Pjeshtëm ose të Plotë, Heqjen dhe Rinovimin e Liçensave në sektorin e Gazit Natyror”, t`i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për licensimin e shoqërisë “PHOENIX PETROLEUM” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI